



# Buletini

- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm (PTV)
- \* Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar (PTF)
  - \* Programi për Hulumtime dhe Publikime
- \* Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial
  - \* Aktivitetet tjera

Korrik 2019

## Aktivitetet nga Programi i Trajnimeve të Vazhdueshme

### Ligji për shoqëritë tregtare

Më 02 korrik 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së organizoj trajnimin me temë: “Ligji për shoqëritë tregtare” .

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me zbatimin efikas të Ligjit për shoqëritë tregtare.



Në pjesën e parë të trajnimit u trajtuan: qëllimet kryesore të ligjit dhe fushëveprimi i tij, mënyrat e themelimit dhe shuarjes së shoqërive tregtare si dhe pasojat juridike që krijojnë. Në pjesën e dytë u trajtuan: mënyrat e organizimit, struktura e kapitalit, dhe të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre dhe personave të tretë si dhe procedurat ligjore dhe aplikimi i tyre në mbrojtjen e të drejtave që rrjedhin nga shoqëritë tregtare.

Me rastin e këtij trajnimi u potencua se shoqëritë tregtare janë bartës të zhvillimit ekonomik në vendet me ekonomi të tregut. Lidhur me këtë Republika e Kosovës ka ndërmarrë masa të ndryshme për të siguruar infrastrukturën e nevojshme për krijim e parakushteve për zhvillimin e biznesit duke miratuar Ligjin për shoqëritë tregtare i cili përbën një bazament të mirë për krijimin e një ekonomie të tregut dhe mundësimin e investime të huaja në Kosovë. Ky ligj përcakton llojet e shoqërive tregtare, kushtet e regjistrimit,

themelimin dhe shuarjen e shoqërive, të drejtat dhe detyrimet e pronarëve, zyrtarëve të shoqërive tregtare, përfaqësuesve të tyre.

Në vazhdim u theksua se në praktikën gjyqësore numri i kontesteve që rrjedhin nga veprimtaria afariste e shoqërive tregtare është i konsiderueshëm, me tendencë të rritjes dhe përkundër përkundër miratimit të legjislacionit adekuat, implementimi i këtij legjislacionit në fuqi për këtë lëmi paraqet sfida, si për ndërmarrjet dhe afaristët, ashtu edhe për praktikuesit e profesioneve juridike dhe sistemin gjyqësor. Në vazhden e këtyre përpjekjeve të vazhdueshme, në Kosovë tanimë aplikohen një sërë ligjesh tregtare dhe ekonomike.

Përveç kornizës ligjore vendore u vunë në pah edhe korniza ligjore ndërkombëtare në këtë fushë siç janë: Konventa e Kombeve të Bashkuara mbi Kontratat për Shitjen Ndërkombëtare të Mallrave (CISG), Konventa e Nju Yorkut e vitit 1958 për Njohjen dhe Zbatimin e Vendimeve të Huaja të Arbitrazhit, Konventa e Parisit për mbrojtjen e pronësisë industriale (20 mars 1883)- organizata botërore e pronësisë industriale, Marrëveshja TRIPS (organizata botërore e tregtisë) si dhe instrumente tjera ndërkombëtare.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin: gjyqtarët nga Departamenti për Çështje Ekonomike i Gjykatës Themelore dhe Gjykatës së Apelit.

## Parashkrimi sipas dispozitave të LMD-së

Më 03 korrik 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së organizoj trajnimin me temë: “Parashkrimi sipas dispozitave të LMD-së”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të gjyqtarëve lidhur me parashkrimin si institut juridik të së drejtës së detyrimeve.

Me rastin e këtij trajnimi u trajtuan: Rregullat e përgjithshme të parashkrimit, llogaritja e fillimit, ndërprerjes, rrjedha e parashkrimit, heqja dorë nga parashkrimi dhe afatet e parashkrimit për kërkesat e caktuara si dhe ndalja e parashkrimit.

Që në fillim u potencua se parashkrimi është institut juridik i së drejtës së detyrimeve sipas të cilit kërkesa e kreditorit nuk mund të realizohet përmes rrugës gjyqësore, për shkak të kalimit të kohës brenda të cilës është dashur të parashtrohet padia. Parashkrimi i kërkesave ndodh me qëllim të garantimit të sigurisë juridike, që kreditorët kërkesat e tyre t’i mbrojnë në afat të caktuar sepse mund të ndodh që të bëhet e pa mundur mbrojtja e të drejtave përmes rrugës gjyqësore, për shkak të kalimit të kohës së përcaktuar me ligj.

Në vazhdim u theksua se instituti juridik i parashkrimit konsiderohet njëri ndër institutet më të rëndësishme të së drejtës detyrimore, sepse ai siguron marrëdhëniet juridike detyrimore të jenë më të qëndrueshme. Kreditorët duhet të jenë shumë të kujdesshëm që kërkesat e tyre të realizohen dhe të mos lejohet që parashkrimi të ketë ndikim në marrëdhëniet e tyre detyrimore. Andaj, parashkrimi paraqet një nga mënyrat e shuarjes së detyrimit deri te i cili vjen me sjellje pasive të kreditorit dhe sjellje aktive të debitorit.

Një ashtu u vequa konkludimi se me dispozitat e LMD-së është përcaktuar rregulli i përgjithshëm i fillimit të rrjedhjes së parashkrimit; parashkrimi fillon të rrjedh ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit në qoftë se me ligj për rastet e veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër. Kjo rregull ka përjashtime (p.sh. kërkesat që parashkruhen për një vit - neni 360 i LMD-së).

Gjithashtu u konkludua se me punë juridike nuk mund të caktohet një kohë më e gjatë ose më e shkurtër e parashkrimit se sa koha e caktuar me ligj, gjithashtu nuk mund të caktohet që parashkrimi të mos rrjedh për një kohë. Nëse palët me kontratë përcaktojnë se debitori ka hequr dorë nga parashkrimi pa kaluar koha e caktuar me ligj, ose parashkrimi do të ndalet së rrjedhuri për një kohë të caktuar, kjo klauzolë nuk ka efekt juridik. Debitori nuk mund të heq dorë nga parashkrimi para se të ketë kaluar koha e caktuar me ligj për parashkrim.

Gjatë këtij trajnimi u përdoren metodat e shpjegimit të pjesshëm teorik, duke u bazuar në raste nga praktika gjyqësore duke u shoqëruar me ushtrime, diskutime interaktive, materialit të ofruar nga trajnuesit, analizës së rasteve studimore si dhe duke zbërthyer dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këtë lëmi.

Përfitues në këtë trajnim ishin: gjyqtarët e gjykatave themelore, gjyqtarët e Gjykatës së Apelit, dhe bashkëpunëtorët profesional.

## Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve

Më 05 korrik 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të PTV-së ka realizuar trajnimin me temë “Mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve“.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve që përmes diskutimeve dhe prezantimit të praktikave më të mira, si dhe përmes elaborimit të dilemave të lartpërmendura të kontribuojnë në mbrojtjen më efektive të të dëmtuarve dhe dëshmitarëve gjatë procesit gjyqësor.

Me rasti e këtij trajnimi është trajtuar mbrojtja e të dëmtuarve dhe dëshmitarëve si kategori e posaçme të cilat janë normuar në Kodin e Procedurës Penale Kosovës si dhe me ligjin për mbrojtjen e dëshmitarëve e të cilat paraqesin kategori të rëndësishme në procesin penal. Vëmendje parësore iu kushtua rasteve nga

praktika, kur të dëmtuarit dhe dëshmitarët nuk dëshmojnë për shkak të ndjenjës së rrezikut për shëndetin, jetën e tyre dhe anëtarëve të familjes. Pikërisht për këtë dukuri u veçua konkludimi se në procedurën penale, mbrojtjes së të dëmtuarit dhe dëshmitarëve duhet t'i kushtohet kujdesi i duhur që të njëjtit mos të kenë ndonjë ndërhyrje ose shqetësim eventual nga jashtë dhe brenda.

Trajnimi u zhvillua në formë të diskutimeve interaktive, ku pjesëmarrësit kishin mundësinë të paraqesin sfidat dhe vështirësitë që ballafaqohen në praktikë.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarë dhe prokuror të nivelit themelor.



## Procedurat e prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës në veçanti kontestet me OSHP-në

Më 11 korrik 2018, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoj trajnimin me temë: “Procedurat e prokurimit sipas Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës në veçanti kontestet me OSHP-në”.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive të pjesëmarrësve lidhur me procedurën e prokurimit publik, standardet ndërkombëtare, evropiane dhe procedurat e tenderimit në OSHP. Në fokus të trajnimit ishin dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, rëndësia e prokurimit publik, procedura e tenderimit, lidhja e kontratës, dispozitat e përgjithshëm lidhur me të drejtat e detyrimet e palëve pas lidhjes së kontratës si dhe administrimi i kontratës dhe përzgjedhja e organit mbikëqyrës.

Po ashtu, gjatë trajnimit u trajtua edhe udhëheqja e procedurave të prokurimit - dispozitat e përgjithshme, fillimi dhe zbatimi fillestar i procedurës së shqyrtimit si dhe shqyrtimi fillestar i shkresave nga eksperti shqyrtues dhe rekomandimi për OSHP-në.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit patën mundësi të adresojnë dilemat dhe vështirësitë që hasen në praktikën gjyqësore aktuale.

Përfitues në këtë trajnim ishin gjyqtarët e Gjykatës Themelore, prokurorët e Prokurorive Themelore si dhe bashkëpunëtorët profesional.



## Program i Specializuar Trajnimi për Zhvillimin e Kapaciteteve në Luftën e Krimit Kibernetik-Sesioni 1

Më 16-17 Korrik 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me UNDP, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, organizoi sesionin e parë të trajnimit të specializuar për zhvillimin e kapaciteteve në luftën kundër krimit kibernetik.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte avancimi i njohurive profesionale të gjyqtarëve dhe prokurorëve, rreth natyrës dhe formave të krimit kibernetik si dhe veprat penale që janë të ndërlidhura me krimin kibernetik.

Sesion i parë i trajnimit ka filluar me njoftimin e pjesëmarrësve lidhur me broshurën që është duke u përgatitur në bashkëpunim me UNDP lidhur me luftimin e krimit kibernetik, për të vazhduar tutje me infrastrukturën ligjore dhe institucionet përkatëse që mund të ndihmojnë në luftimin e kësaj dukurie, qoftë në nivel vendor si Këshilli Kombëtar në kuadër të MPB-së kundër

Krimit Kibernetik, i cili ka hartuar Strategji për 2016-2019, mandej Forenzika Kibernetike në kuadër të Policisë së Kosovës, si dhe institucionet dhe mekanizmat e domenit ndërkombëtar si Konventa e Këshillit të Evropës për Krimin Kibernetik (Konventa e Budapestit e 23 nëntorit 2001) dhe shumë organizata ndërkombëtare dhe nisma rajonale aktive në luftimin e krimit kibernetik.

Në kuadër të këtij trajnimi u trajtuan krimi kibernetik dhe sfidat në luftimin e tij, dilemat dhe vështirësitë e të provuarit të veprave të natyrës së krimit kibernetik, ndërlidhjen e këtij krimi apo shfrytëzimi i sistemit informativ në kryerjen e veprave tjera të ndërlidhura penale.

Përfitues të trajnimit ishin gjyqtarë dhe prokurorë të nivelit themelor, të regjioneve të ndryshme të Kosovës.



## Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale

Më 19 - 21 Korrik 2019, Akademia e Drejtësisë në bashkëpunim me Departamentin Ligjor i SHBA-së/OPDAT, në kuadër të Programit për Trajnime të Vazhdueshme, ka realizuar trajnimin me temë “Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale”.



Qëllimi i realizimit të këtij trajnimi ishte diskutimi i sfidave që kanë dal si rezultat i trajnimeve të realizuara deri me tani si dhe mënyra e realizimit të trajnimeve në të ardhmen.

Gjatë tri dite trajnimi është diskutuar rreth përmbledhjes së të gjitha trajnimeve lidhur me ndryshimet substanciale të Kodit Penal dhe Kodit të Procedurës Penale, marrja e hapave të mëtutjeshëm lidhur me trajnimet vijuese plotësimi dhe ndryshimi eventual i agjendës së trajnimeve të deritanishme si dhe diskutimi i propozimeve konkrete dhe arsyetimeve. Gjithashtu gjatë trajnimit janë diskutuar nene të veçanta të KPPK-së.

Trajnimi nxori në pah se ende ka nevojë për organizimin e trajnimeve për Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale për shkak të numrit të madhe të gjyqtarëve dhe prokurorëve edhe pamundësisë së përfshirjes të gjithëve në raundin e parë të trajnimeve.

Pjesëmarrës në këtë aktivitet trajnues ishin: gjyqtarë, prokurorë, profesor nga Fakulteti Juridik si dhe avokat.



## Aktivitetet nga Programi i Trajnimit Fillestar

### Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII)

Në kuadër të programit të trajnimeve fillestare për gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII), gjatë muajit korrik janë realizuar 16 sesione trajnuese, 2 sesione trajnuese janë realizuar nga moduli: “Rendi Juridik Kombëtar dhe Ndërkombëtarë”, 14 sesione janë realizuar nga moduli: “E drejta civile, administrative dhe ekonomike”.



Nga nën moduli: Organizimi i Sistemit Gjyqësor dhe Prokurorial janë realizuar dy (2) sesione trajnuese ku u trajtuan: Këshilli i Evropës, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 2 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Neni 4 i Protokollit 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe Neni 5 par.1 i KEDNJ - Prezumimi në favor të lirisë.

Në kuadër të nën modulit: “E drejta e pronësisë dhe të drejtat tjera të përafërta – pjesa e dytë janë realizuar dy (2) sesione trajnuese përmes të cilëve gjyqtarët patën rastin të përfitojnë njohuri të reja nga: humbja drejtës së pronësisë, dhe e drejta e ndërtimit (Superficies).

Gjatë realizimit të nën modulit: “Procedura Jo kontestimore” janë realizuar tre (3) sesione

trajnuese, ku u shtjelluan: Dispozitat e përgjithshme të Ligjit të procedurës jokontestimore, shpallja e zhdukjes së një personi, shpallja e vdekjes së një personi dhe procedura e të provuarit të vdekjes, caktimi i lartësisë së kompensimit për paluajtshmërinë e ekspropriuar, rregullimi i megjës (sinorëve) dhe ndarja fizike.

Gjithashtu në përmbushje të trajnimit teorik, në këtë periudhë janë realizuar edhe tre (3) sesione trajnuese nga nën-moduli: “ E drejta e punës” ku gjyqtarët patën rastin të njoftohen me gjerësisht me temat: Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit të Punës, Kontestet nga marrëdhënia e punës sipas Ligjit për Shërbyesit Civil, Mbrojtja në punë dhe kompensimi i dëmit i shkaktuar në punë.

Në kuadër të nën modulit: “Marrja dhe administrimi i provave në procedurën civile” janë realizuar tre (3) sesione trajnuese përmes një metodologji të kombinuar duke përfshirë ligjërime teorike dhe diskutime interaktive rreth objektivave mbi: Mjetet provuese dhe objekti i të provuarit, marrja e provës, sigurimi i provës, mjete provuese dhe këqyrja në vend.

Ndërsa komponenta e trajnimit praktik, për këtë periudhë është realizuar përmes vijimit të praktikës nga ana e gjyqtarëve të sapoemëruar në gjykatat përkatëse konform orarit të përcaktuar me program. Trajnimin fillestar për gjyqtarët e sapo emëruar janë duke e ndjekur (39) gjyqtarë të sapo emëruar, shtatë (7) prej të cilëve janë të komunitetit serb.

Po ashtu, në drejtim të përmbushjes së programit praktik trajnues, gjyqtarët e sapo emëruar kanë vijuar trajnim edhe në institucionin Policor të Kosovës.



## Aktivitetet e realizuara në kuadër të trajnimit fillestar për prokurorët e sapo emëruar (gjenerata e VIII)

Gjatë kësaj periudhe në kuadër të trajnimit teorik janë realizuar gjithsej 20 (njëzetë) sesione trajnuese ku 12 (dymbëdhjetë) sesione nga moduli: Kodi Penal i Republikës së Kosovës, 8 (tetë) sesione nga moduli: “Kodi i Procedurës Penale”.

Nga nën moduli: “Kodi penal – pjesa e përgjithshme” janë realizuar (6) gjashtë sesione trajnuese ku prokurorët e sapoemëruar patën mundësinë të përfitojnë njohuri të reja, mbi këto çështje: Vendi dhe koha e kryerjes së veprës penale, kundërligjshmëria, përgjegjësia penale, fazat e kryerjes së veprës penale, funksioni dhe sistemi i sanksioneve penale, karakteristikat kryesore të ekzekutimit të sanksioneve penale.

Ndërsa nga nën moduli: “Kodi Penal – pjesa e veçanë” janë realizuar 6 (gjashtë) sesione trajnuese ku prokurorët e sapoemëruar patën mundësinë të zgjerojnë njohuritë rreth veprës penale dhe elementeve të saj.

Në këtë periudhë nga nën moduli: “Shqyrtimi fillestar i dytë, dhe shqyrtimi gjyqësor” janë

realizuar 4 (katër) sesione trajnuese ku u shtjelluan: Procedura paraprake-parashtrimi i kallëzimit penal, fillimi dhe kohëzgjatja e hetimeve, pezullimi dhe pushimi i hetimeve, zgjerimi dhe rifillimi i hetimeve, dhe masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe hetimit.

Gjithashtu nga nën moduli: “Ekspertiza dhe Analiza” janë realizuar 4 (katër) sesione, dhe u diskutua mbi këto tema: Ekspertimi si veprim procedural në procedurë penale, eksperti dhe pozita procedurale e tij në procedurë penale, dhe ekspertiza (Deklarata e ekspertit) si provë në procedurë penale.

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 12 ditë trajnim praktik në prokurori konform orarit të përcaktuar, 1 ditë vizitë në institucionin Policor të Kosovës konform orarit të përcaktuar.

Trajnimin fillestar janë duke e ndjekur (12) prokuror të sapo emëruar.



## Vizitë/trajnim praktikë i gjyqtarëve dhe prokurorëve të shtetit të sapo emëruar në Policinë e Kosovës

ë 24 korrik 2019, Akademia e Drejtësisë në kuadër të Programit të Trajnimit Fillestar, për gjyqtarët, dhe prokurorët sapoemëruar ka organizuar trajnimin praktik në Policinë e Kosovës.



Trajnimi në këtë institucion, kishte për qëllim që gjyqtarët dhe prokurorët e sapoemëruar të avancojnë njohuritë e tyre rreth mandatit, rolit, strukturës dhe punës praktike të Policisë së Kosovës.

Në këtë vizitë gjyqtarët dhe prokurorët e shtetit të sapo emëruar fillimisht u njoftuan me bazën ligjore dhe strukturën organizative të Policisë së Kosovës, rolin e saj, llojet e hetimeve, bashkëpunimin ndërkombëtarë në fushën e zbatimit të ligjit, ngritjen e kapaciteteve, si dhe

sfidat me të cilat ballafaqohen pjesëtarët e policisë e që ndërlidhen me punën e gjyqtarit dhe prokurorit.

Në fokus ishin rastet për narkotikët dhe substancat psikotrope, rastet e shumta që hasen sidomos gjatë kalimit të pikave kufitare, hetimi i trafikimit me qenie njerëzore, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar që ka Kosova me shtetet e tjera.

Duke u bazuar në faktin që puna e gjyqtarëve dhe prokurorëve është e ndërlidhur ngushtë me punën e policisë, prokurorët, po ashtu edhe gjyqtarët e sapoemëruar kishin rastin që të ngritin çështje me interes për punën e tyre praktike, për bashkëpunimin aktual dhe formave adekuate të bashkëpunimit në të ardhmen mes policisë në njërën anë dhe gjykatave dhe prokurorive në anën tjetër.

Përfitues të këtij trajnimi ishin gjyqtarët e sapo emëruar (gjenerata e VII) dhe prokurorët e shtetit të sapoemëruar (gjenerata e VIII).



## Programi për Hulumtime dhe Publikime

### Ceremonia e botimeve ligjore

Me 02 korrik 2019, Akademia e Drejtësisë në mbështetje të GIZ realizoj ceremoninë e publikimit të katër botimeve ligjore si: Hyrje në të drejtën ligjore, Fjalori Juridik, Udhëzuesi për procedurën administrative si dhe Doracaku i të Drejtave të Njeriut.



Të pranishmëve në këtë ceremoni iu drejtuan me një fjalë rasti z. Valon Kurtaj, Drejtor Ekzekutiv në Akademinë e Drejtësisë, Drejtori i GIZ-it për Kosovë z. David Oberhuber.

Në emër të autorëve të botimeve të pranishmëve në këtë ceremoni iu drejtuan. Prof. Dr. Haxhi Gashi, Prof. Dr. Iset Morina, Kryetari i Gjykatës së Apelit z. Hasan Shala si dhe Prof. Dr. Iliriana Islami.

z. Valon Kurtaj në mes tjerash theksoj se këto katër botime do ti kontribuojnë ngritjes së kapaciteteve të gjyqësorit dhe juristëve të rinj dhe veçanërisht do të jenë lehtësues gjatë punës praktike. Më tej ai në fjalën e tij shprehu falënderim për GIZ të cilët kanë mundësuar realizimin e këtyre botimeve dhe autorëve në hartimin e tyre duke kontribuar kështu në pasurimin e koleksioneve të bibliotekës së Akademisë dhe literaturës tonë juridike.

Drejtori i GIZ për Kosovë z. David Oberhuber

në fjalimin e tij mes tjerash përmendi katër botimet me radhë duke theksuar rëndësinë e secilit botim dhe mundësinë e mirë për shfrytëzimin praktik nga ana e zbatuesve të ligjit.

Edhe autorët e botimeve po ashtu theksuan rëndësinë e këtyre botimeve për gjithë komunitetin ligjor meqenëse janë një mundësi e mirë për zhvillimin profesional si dhe një praktikë e mirë me rastin e hartimit të shkresave të ndryshme gjatë punës praktike si dhe në procesin e bërjes së drejtësisë. Më tej ata në fjalët e tyre shprehën falënderim të veçantë për Akademinë dhe GIZ të cilët kanë mundësuar krijimin e tyre e veçanërisht edhe bashkë autorët e botimeve të cilën kanë kontribuar në hartimin e tyre.

Në këtë ceremoni morën pjesë, përfaqësues nga Ambasada Gjermane, Drejtori i GIZ për Kosovë, kryetarë të gjykatave, gjyqtarë mbikëqyrës, prokuror, profesor universitar, zyrtarë ligjor nga institucione të ndryshme të sistemit të drejtësisë, studentë, zyrtarë nga GIZ it si dhe nga Akademia e Drejtësisë.



## Aktivitetet për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial

### Zhvillimet kryesore në administratën e sistemit prokurorial

Më 04 dhe 05 Korrik 2019, Akademia e Drejtësisë, në kuadër të trajnimeve për stafin administrativ gjyqësor dhe prokurorial, ka realizuar trajnimin me temë: “Zhvillimet kryesore në administratën e sistemit prokurorial”.



Qëllimi i këtij trajnimi ishte që pjesëmarrësit të kuptojnë zhvillimet kryesore lidhur me zbatimin e Ligjit për Paga, Ligjit për Zyrtarët Publik si dhe ti njoftohen me zhvillimet dhe reformën rreth administratës së prokurorisë.

Gjatë trajnimit pjesëmarrësit janë njoftuar me hapat konkret që janë duke u bërë në kuadër të reformës së administratës së sistemit prokurorial, proceset e brendshme dhe të jashtme të punës si dhe mënyrat më ideale për të pasur efikasitet të lartë në punë.

Po ashtu pjesëmarrësit patën rastin që përmes diskutimit të njoftohen me reformat dhe zhvillimet në administratën e Prokurorisë së Shtetit duke pasur mundësi që ti shkëmbejnë përvojat dhe të japin ide në funksion dhe fuqizim të administratës së sistemit prokurorial.

Përfitues të këtij trajnimi ishin, Administratori nga Prokuroria e Apelit, Prokuroria Speciale si dhe Administratorët e Prokurorive Themelore.



## Aktivitetet tjera

### Takimi i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë

Prishtinë, 05 korrik 2019 – është mbajtur takimi i tetëmbëdhjetë me radhë i Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë, i udhëhequr nga z. Aleksandër Lumezi, Kryesues i Këshillit Drejtues - Kryeprokuror i Shtetit.

Këshilli Drejtues në këtë takim, fillimisht në bazë të kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë miratoi dorëheqjen e tij, pas emërimit të tij nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës si gjyqtar i Departamentit Special në kuadër të Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Anëtarët e Këshillit Drejtues falënderuan z. Valon Kurtaj për kontributin e dhënë për gjatë dy viteve në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv në zhvillimin e proceseve të punës në AD për funksionim efikas dhe realizimin e mandatit ligjor të saj.

Nga ana tjetër z. Kurtaj falënderoi anëtarët e Këshillit Drejtues të AD-së për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme në organizimin dhe udhëheqjen e punës në Akademi.

Më tej, Këshilli Drejtues vendosi për emërimin e znj. Luljetë Hetemi – Udhëheqëse e Programit për Hulumtime dhe Publikime në AD si ushtruese e detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të AD-së. Gjithashtu, Këshilli Drejtues përgjatë këtij takimi mori vendim për fillimin e procedurës për rekrutimin e Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë.

Në këtë takim, përpos të lartë theksuarave, Këshilli Drejtues diskutoi edhe çështje të tjera të rëndësishme për funksionimin e mirë të Akademisë së Drejtësisë.



## Raport nga takimi i parë i Rrjetit të Trajnuesve gjyqësor lidhur me Krimin Kibernetikë dhe Provat elektronike, të Këshillit të Evropës

Më dt. 10-12 korrik 2019, në Strasburg të Francës është realizuar takimi i parë i Rrjetit të Trajnuesve gjyqësor lidhur me Krimin Kibernetikë dhe Provat elektronike. Ky takim është mbështetur nga Këshilli i Evropës dhe kanë marr pjesë trajnues gjyqësor dhe përfaqësues të institucioneve trajnuese të më shumë se 20 vende të Evropës, Afrikës, Amerikës Latine dhe Azisë Paqësore.



Qëllimi i këtij takimi ishte që trajnuesit gjyqësor:

Të njihen me sfidat aktuale ndërkombëtare në fushën e krimit kibernetikë dhe provave elektronike, përfshirë aspektin në raport me Konventën e Budapestit dhe punën e T-CY;

Përshtatja e nevojave të vendeve të cilat janë pjesë e projektit të Këshillit të Evropës lidhur me trajnimin gjyqësor për krimin kibernetikë dhe provat elektronike;

Përcaktimi i nevojave, përshtatshmëria dhe hapat që do të ndërmerren lidhur me rrjetin e trajnuesve nacional gjyqësor për krimin kibernetikë dhe provat elektronike.

Fokusi i këtij takimi ishte i përqendruar në ofrimin e shkathtësive të nevojshme për gjyqtarët dhe prokurorët, në fushën e krimit kibernetik sidomos përmes trajnimit dhe krijimit të rrjeteve. Qëllimi i këtij koncepti është që t'ju ndihmohet institucioneve të trajnimit gjyqësor që të zhvillojnë programe trajnuese lidhur me krimin kibernetikë dhe provat elektronike për gjyqtarë dhe prokurorë, si dhe programet e tilla të integrohen në trajnimet e rregullta të zhvillimit profesional.

Në këtë takim u potencua se zhvillimi i programeve të trajnimit të qëndrueshëm është e vetmja mënyrë efektive për të siguruar që gjyqtarët dhe prokurorët të kenë njohuri të mjaftueshme për të përmbushur rolin e tyre në këtë fushë.

Pjesëmarrësit gjatë këtij takimi ndanë përvojat e tyre, praktikat me të mira si dhe nevojat dhe prioritetet që kanë të bëjnë me këtë fushë si dhe hapat që duhet ndërmarr në lidhje me një rrjet të trajnerëve gjyqësorë vendas për krimin kibernetikë dhe provat elektronike.

Përfitues të këtij trajnimi ishin: një gjyqtarë dhe dy prokurorë, njëherit trajnues të Akademisë në këtë fushë, dhe U.D Koordinatori i Programit



**Akademia e Drejtësisë dhe GIZ nënshkruajnë Memorandum Mirëkuptimi për realizimin e aktiviteteve të përbashkëta për vitin 2019-2020 si dhe Memorandum të Mirëkuptimit për Transferimin e të Drejtave të Pronësisë dhe të Drejtave të tjera të Autorit për 4 botime ligjore**

Prishtinë 29 korrik 2019, znj. Luljete Hetemi, - u.d. Drejtor Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë dhe z. Karl Weber – udhëheqës i GIZ - Projekti për Reformat Ligjore dhe Administrative ( GIZ- LARP), kanë zhvilluar një takim.

Në fillim të këtij takimi z. Weber uroi znj. Hetemi për pozitën e Ushtruesit të Detyrës së Drejtorit Ekzekutiv të Akademisë së Drejtësisë, duke theksuar se GIZ dhe ai personalisht janë në dispozicion të mbështetjes gjatë ushtrimit të këtij funksioni.

znj. Hetemi falënderoi GIZ për përkrahjen e vazhdueshme që i jep Akademisë me qëllim të realizimit të funksioneve saj.

Temë kryesore e këtij takimi ishte diskutimi për aktivitetet e përbashkëta dhe nënshkrimi i Marrëveshjes për zbatimin e këtyre aktiviteteve

gjatë viteve 2019-2020 si dhe nënshkrimi i disa Memorandumeve të Mirëkuptimit ndërmjet AD-së, GIZ dhe autorëve të botimeve si: Hyrje në sistemin ligjor në Kosovë, Fjalori juridik, Udhëzuesi për procedurën e përgjithshme administrative si dhe Doracaku për të Drejtat e Njeriut të publikuara së fundmi, për kalimin e të drejtës autoriale në pronësi të Akademisë së Drejtësisë. E gjitha kjo me qëllim që këto botime të jenë të qasshme për përfutuesit e Akademisë dhe mundësinë e rishtypjes për nevojat e gjyqësorit.

Në fund të takimit z. Weber njoftoi znj. Hetemi se GIZ është në proces të printimit edhe të disa ekzemplarëve të këtyre botimeve, për shkak të kërkesave të mëdha nga gjyqësori dhe komuniteti ligjor në përgjithësi.



## Programi i praktikës në Akademinë e Drejtësisë

Më datë 31 korrik 2019, në Akademinë e Drejtësisë kanë përfunduar praktikën me sukses tre juristë të rinj të cilët kanë qenë përfitues të këtij programi praktik për pesë muaj me radhë në saje të bashkëpunimit të mirëfilltë ndërmjet Akademisë së Drejtësisë dhe UNDP-së.



Gjatë periudhës së praktikës, juristët e rinj patën mundësi të mësojnë për së afërmi aktivite-

tet e Akademisë dhe të njihen me funksionimin e sistemit gjyqësor dhe prokurorial me fokus në pjesën e arsimit ligjor si të vazhdueshëm ashtu edhe fillestar si dhe të përfitojnë nga pjesëmarrja në trajnimet e organizua nga Akademia.

Gjithashtu gjatë praktikës kanë asistuar stafin e Akademisë në përgatitjen e trajnimeve dhe aktiviteteve të ndryshme duke kontribuar në efikasitetin dhe cilësinë si dhe në mbarëvajtjen e punës.

Pas përfundimit të praktikës, u.d. Drejtori Ekzekutiv i Akademisë së Drejtësisë në një koktej rasti, u shpërndau certifikata duke i falënderuar për kontributin e dhënë dhe duke iu uruar avancim në karrierë dhe në përgatitjen akademike.





**<https://ad.rks-gov.net>**

**Adresa “Lagjja e Spitalit”  
Rr. Muharrem Fejza p.n  
Prishtinë, Republika e Kosovës**

**Tel: + 381 38 200 18 660  
Fax: + 381 38 512 095  
E-mail: [infoad@rks-gov.net](mailto:infoad@rks-gov.net)**